



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

OSNOVNI SUD GNJILANE

Broj predmeta: 2019:082266

Dana: 01.07.2019

Broj dokumenta: 00385503

P.nr.289/19

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Snezhana Mihajloviq, me sekretaren juridike Suzana Kovaçeviq, në çështjen penale kundër të pandehurit A... Sh... nga fshati P., Komuna e Gj..., për shkak të veprës penale “lëndim I lehte trupor” nga neni 188 i KPPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.336/2019 të datës 22.03.2019, në bazë të nenit 358 paragr.1 nën paragr.1.3 KPPRK dhe nenit 12 paragr.12.5 Ligji mbi Ndërmjetësimin, jashtë seancës gjyqësore, më datë 01.07.2019 mori kete:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim e arritur në mes të pandehurit A. Sh... nga fshati P.,Komuna e Gj.... dhe të demtuarit A... A..., e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Gj, me datë 21.06.2019 me numër Nd...../19.

II. HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan PP.II.nr 336/2019 e dt. 22.03.2019 dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit nga fshati P, Komuna e Gj ku edhe jeton, shtetas i Republikës së Kosovës, për shkak se i pandehuri ka arritur marrëveshjen për ndërmjetësim me palën e dëmtuar.

III. Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP.II.nr.336/2019 të dt 22.03.2019. ka akuzuar..., për shkak të veprës penale “lëndim I lehte trupor”nga neni 188 KPPK. Kjo gjykatë me kërkesën e të pandehurit dhe të dëmtuarit ka dërguar lëndën në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjilan.

Më dt. 17.06.2019 në Qendrën e Ndërmjetësimit në Gjilan, është arritur marrëveshja për zgjidhjen e kësaj çështje penale përmes ndërmjetësimit në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit.

Qendra për Ndërmjetësim më dt. 13.06.2019 me Vendimin..., ka pranuar marrëveshjen e palëve për zgjidhjen e ndërmjetësuar.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lartë dhe në bazë të nenit 358 paragr. 1 nënparagr. 1.3 KPPRK dhe nenit 12 paragr.12.5 Ligji mbi Ndërmjetësimin, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.289/2019 i dt. 01.07.2019

Sekretarja juridike,
gjykuese,
Suzana Kovaçeviq

Gjyqtarja e vetme
Snezhana Mihajllloviq

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.
Kjo marrëveshje e ka fuqinë e titullit ekzekutiv.

Broj predmeta: 2019:082266
Dana: 01.07.2019
Broj dokumenta: 00385503